



**Hapet Thirrja për mobilitet stafi të UPT-së
në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus +
në Università degli Studi della Tuscia, Itali.**

Në kuadër të marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për mobilitet për stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Università degli Studi della Tuscia, <http://www.unitus.it/>

Lloji i mobilitetit përfshin: Pjesëmarrje në javën ndërkombëtare të stafit, (*IV International Staff Week of the University of Tuscia*).

Fusha e trajnimit: Të gjitha njësitë kryesore, drejtoritë në UPT. Staf akademik ose administrativ.

Numri total i stafit: 1 (Si dhe 1 staf tjetër rezervë, në vartësi të konfirmimit nga zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare e UNITUS.)

Koha e kryerjes së mobilitetit: 5 ditë + 2 ditë udhëtim, 16 – 20 dhjetor 2024

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik/administrativ:

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës*;
- Letra konfirmuese nga universiteti pritës, për stafin akademik/administrativ **;
- Dokumenti Mobility Agreement (Staff Mobility for Training) për stafin, në universitetin pritës***.

**Plani i mobilitetit dhe periudha e propozuar e mobilitetit duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore ku aplikanti bën pjesë.*

***Kandidatët që do të aplikojnë për të qenë pjesë e mobilitetit si staf akademik ose administrativ në universitetin pritës, paraprakisht duhet të kenë aprovimin nga universitetin pritës (Dekan/Titullar Departamenti ose program studimi/Profesor), për kryerjen e aktivitetit gjatë periudhës së mobilitetit. Ai/ajo do të duhet t'ju dërgojë një dokument paraprak aprovues, të cilin do të duhet ta bashkangjisni me dokumentet e tjera për aplikimin tuaj.*

**** Mobility Agreement for Training për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Për të shkarkuar formatin Staff Mobility for Training, ju lutemi klikoni te: [Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit – Universiteti Politeknik i Tiranës \(upt.edu.al\) Aneks 3](#).

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: 14 nëntor 2024, ora 12.00.



Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT dhe për sigurimin e materialeve informuese për UPT–në në këtë aktivitet, ju lutemi kontaktoni në email: abeqo@upt.al , rkodra@upt.al

Pas përfundimit të mobilitetit, personi pjesëmarrës në javën ndërkombëtare të stafit në Viterbo, duhet të dorëzojë një raport te departamenti/drejtoria përkatëse lidhur me aktivitetin.